



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:056793

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05875091

KPPP.nr.2551/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Banka Ekonomike” SH.A., me seli në Prishtinë, sheshi “Nënë Tereza”, kundër debitorëve 1. “Rofix” SH.P.K., me NRB:70147529, me seli në Klinë, fshati Volljak, 2. K.M., me adresë në Prizren, rruga “Luigj Gurakuqi” nr.51, 3. N.N.T. “Toni” me seli në Prizren, rruga “Atmaxhë”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Aktvendimit E.nr.486/12 të datës 05.11.2012, të lejuar nga Gjykata Komunale në Klinë, jashtë seancës me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit 1. “Rofix” SH.P.K., dhe Aktvendimi E.nr.486/12 i datës 05.11.2012, i lejuar nga Gjykata Komunale në Klinë, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale në Klinë duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar Aktvendimin E.nr.486/12 të datës 05.11.2012, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor – Marrëveshjen mbi pengun nr.5167 e datës 02.06.2011, si dhe Marrëveshja mbi pengun nr.5168 e datës 02.06.2011, vërtetimin mbi regjistrimin e pengut me numër R-1011250910 të datës 25.11.2010, me të cilin ka urdhëruar debitorët që pas pranimit të këtij urdhri t’i paguajnë debitorit shumën prej 16,023.65 €, me normën e interesit të rregullt për kredi 21.50 %, dhe mbitërheqje 14.40 % si dhe interesin ndëshkues 3% në muaj duke filluar nga data 29.09.2012 e deri në pagesën përfundimtare, nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë, me

bllokimin e llogarive bankare, me sekuestrimin, konfiskimin, shitjen e kolateralit të lënë peng deri në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se nga propozimi për përmbarim shihet qartë se S.M. si person fizik nuk është askund i përfshirë si palë në këtë procedurë, andaj as në praktiken gjyqësore nuk është hasur ndonjë rast që të obligohet përfaqësuesi i autorizuar i personit juridik për pagesën e borxhit ndaj personave të tjerë. Tutje ka shtuar se i njëjti si person i autorizuar i debitorit i ka nënshkruar marrëveshjet për kredi si dhe marrëveshjet e tjera, por i njëjti nuk është pronar i debitorit të parë. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, si dhe ta anuloj aktvendimin mbi lejimin e përmbarimit.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit, duke theksuar se prapësimi i debitorit nuk është i mbështetur në prova ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore të LPP-së. Tutje ka shtuar se debitori me autorizim ka nënshkruar marrëveshjen e kredisë dhe të pengut në emër të “Rofix” SH.P.K., për të cilën S.M. është referuar si pronar, dhe po ashtu i njëjti ka nënshkruar marrëveshjen pranë kreditorit se merr përgjegjësi të plotë për pagesën e detyrimeve që dalin nga marrëveshjet e nënshkruara me kreditorin, propozimi i kreditorit është tërësisht ligjor dhe i bazuar në dokumente të përmbarueshëm. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. ndërsa me nenin 5, paragrafi 2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se dokument përmbarues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*. Në anën tjetër, me nenin 27, paragrafi 1 të LPP-

së, është përcaktuar se *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, ndërsa me nenin 36 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Marrëveshja mbi pengun nr.5167 e datës 02.06.2011, si dhe Marrëveshja mbi pengun nr.5168 e datës 02.06.2011, në bazë të së cilave është mbështetur propozimi për përmbartim janë bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar tek organi kompetent, e rrjedhimisht propozimi për përmbartim është paraqitur në kundërshtim me neni 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*

Andaj nga të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit E.nr.486/12 i datës 05.11.2012, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbartim nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit përmbartimor dhe rrjedhimisht propozimi për përmbartim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar përmbartimi.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbartim, ndërsa organi përmbartues – Gjykata Komunale në Klinë, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbartim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbartues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi aktvendimin përmbartimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata në kuptim të nenit 38, 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2551/22, datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.